



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/07

Datë: 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063, dhe Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 13, paragrafi 1, të Ligjit Nr.10/L-001 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 500.000€ (pesëqind mijë eurosh), për mbështetjen e Federatës së Futbollit të Kosovës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga programi "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 232, nënprogrami "Shpenzimet e Paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezerva" dhe transferohen në Ministrinë e Financave, me kod 201, në nënprogramin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Autorizohet Thesari që të realizojë transferin e mjeteve sipas pikës 1. të këtij Vendimi në llogarinë bankare të caktuar nga Federata e Futbollit të Kosovës.
4. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/07
Datë: 30.03.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 32 të Ligjit Nr.10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet dhënia e pagës së trembëdhjetë (13), e cila do të paguhet së bashku me pagën e muajit mars, për të gjithë të punësuarit që marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë Vendim.
2. Mjetet për mbulimin e kostos së përcaktuar në pikën 1. të këtij Vendimi, sigurohen përmes alokimit të parakohshëm të buxhetit për paga në secilën organizatë buxhetore përkatëse. Autorizohet Thesari i Kosovës në Ministrinë e Financave që të kryej përlllogaritjet dhe të gjitha veprimet e nevojshme për alokim të parakohshëm.
3. Paga e trembëdhjetë (13) e plotë u takon të gjithë të punësuarve me pagë primare, sipas listës së pagave të muajit mars 2026, të cilët janë të punësuar me orar të plotë dhe që kanë qenë të punësuar gjatë tërë dymbëdhjetë (12) muajve të fundit në një organizatë buxhetore.
 - 3.1. Paga e trembëdhjetë (13) e plotë është e barabartë me pagën bazë të përfituesit, e cila llogaritet duke shumëzuar njësitë e koeficientit të pozitës së të punësuarit me vlerën e koeficientit, pa përfshirë shtesat tjera, e përcaktuar sipas Ligjit Nr. 08/L-196 të Pagave në Sektorin Publik.
4. Paga e trembëdhjetë (13) e pjesshme u takon të gjithë të punësuarve me pagë primare sipas listës së pagave të muajit mars 2026, të cilët janë të punësuar me orar jo të plotë ose kanë qenë të punësuar për më pak se dymbëdhjetë (12) muaj në një organizatë buxhetore përgjatë dymbëdhjetë (12) muajve të fundit.
 - 4.1. Paga e trembëdhjetë (13) e pjesshme është e barabartë me shumën e të gjitha pagave bazë që i punësuari ka pranuar nga puna primare në një organizatë buxhetore përgjatë dymbëdhjetë (12) muajve të fundit, e pjesëtuar me numrin dymbëdhjetë (12).
5. Për të punësuarat që kanë qenë në pushim të lehonisë sipas legjislacionit në fuqi, gjatë dymbëdhjetë (12) muajve të fundit, koha e kaluar në pushim të lehonisë llogaritet si kohë e kaluar në punë me orar të plotë për qëllime të përlllogaritjes sipas pikave 3, dhe 4, të këtij Vendimi.

6. Përfshihet nga pikat 3, dhe 4, të punësuarit e suspenduar sipas legjislacionit në fuqi, nuk kualifikohen për përfitim nga paga e trembëdhjetë (13) të sipas këtij Vendimi.
7. Çdo i punësuar ka të drejtë të përfitojë vetëm një pagë të trembëdhjetë (13) sipas këtij vendimi, pavarësisht pozitave apo funksioneve shtesë që ushtron aktualisht apo të ketë ushtruar gjatë dybëdhjetë (12) muajve të fundit. Për qëllime të përlogaritjes sipas pikave 3, dhe 4, për bazë do të merret paga më e favorshme e të punësuarit në muajin përkatës.
8. Obligohet Ministria e Financave, Thesari i Kosovës dhe organizatat buxhetore për zbatim të këtij Vendimi.
9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/07
Datë: 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/07

Datë: 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Inspektoratin Qendror të Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Ndërtimit, si dhe për Mbrojtjen nga Krezatimi dhe Siguria Bërthamore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/07
Datë: 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Financimin e Menaxhimit të Resurseve Ujore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
1. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/07
Datë: 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Banim Social dhe të Përballueshëm.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/07
Datë: 30.03.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 4 dhe 5, të Ligjit Nr. 08/L-036 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit, Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 2803 e datës 17 nëntor 2025, ftesës së Komandës Qendrore të Shteteve të Bashkuara të datës 8 dhjetor 2025, për Komandantin e FSK-së për të marrë pjesë në Konferencën e Dohas në Katar, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Mbrojtjes për të kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, marrjen e Vendimit për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit, përkatësisht si pjesë e Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese në Gaza.
2. Dërgimi i FSK-së në këtë mision, përfshin:
 - 2.1. Detyra e misionit të FSK-së është pjesëmarrja e personelit të FSK-së, në kuadër të Komandës së Unifikuar të Forcës Ndërkombëtare të Stabilizimit (FNS), e cila ka për mision të mbështesë zbatimin e Planit Gjithëpërfshirës për t'i Dhënë Fund Konfliktit në Gaza;
 - 2.2. Lloji i Operacionit: operacion ndërkombëtar i paqes;
 - 2.3. Vendi i kryerjes së misionit është Gaza;
 - 2.4. Legjislacioni i zbatueshëm: Ligji Nr. 08/L-036 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit, si dhe legjislacioni tjetër i zbatueshëm në Kosovë. Bazuar në Mandatin e Forcës Ndërkombëtare të Stabilizimit (i nxjerrë nën Autoritetin e Bordit të Paqes), të gjitha operacionet e FNS-së do të kryhen në përputhje me (a) Kartën e Kombeve të Bashkuara; (b) Të drejtën ndërkombëtare detyruese të zbatueshme, përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare; (d) Rregullat e Angazhimit të FNS-së; (c) Marrëveshjet e zbatueshme për Mbrojtjen e Statusit dhe instrumentet e tjera detyruese të zbatueshme. Shtetet pjesëmarrëse ruajnë juridiksion ekskluziv mbi personelin e tyre për çështje penale dhe administrative, që rrjedhin nga operacionet e FNS-së. Asnjë personel i FNS-së nuk do të dorëzohet, transferohet ose vihet në dispozicion, as informacion që lidhet me operacionet e FNS-së t'u ofrohet ndonjë tribunali, gjykatë ose mekanizmi ndërkombëtar, pa pëlqimin e shprehur të shtetit pjesëmarrës;
 - 2.5. Në këtë mision mund të dërgohen pjesëtarë/personel të FSK-së në varësi të nevojave të Forcës Stabilizuese Ndërkombëtare, si dhe dakordimeve paraprake mes palëve, gjithnjë duke marrë për bazë kapacitetet e FSK-së. Në këtë fazë përcaktimi i numrit të sakët është i pamundur. Mirëpo, numri i personelit të FSK-së pjesëmarrës në Forcën Stabilizuese Ndërkombëtare në këtë fazë është njëzetedy (22);

- 2.6. Koha e zgjatjes së këtij misioni, bazuar në Mandatin e Forcës Ndërkombëtare të Stabilizimit (i nxjerrë nën Autoritetin e Bordit të Paqes), ky mision/mandat mbetet në fuqi derisa të ndryshohet ose të përfundojë, bazuar në kushtet në terren dhe siç përcaktohet nga Bordi i Paqes, me mundësi ndryshimi dhe rishikimi;
 - 2.7. Në këtë mision, FSK-ja është nën Komandën e Unifikuar të FNS-së, siç përcaktohet në Mandatin e Forcës Ndërkombëtare të Stabilizimit (i nxjerrë nën Autoritetin e Bordit të Paqes);
 - 2.8. Kostoja financiare për realizimin e këtij misioni mbulohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës;
 - 2.9. Kufizimet në këtë mision për personelin e FSK-së janë të përcaktuara në Mandatin e Forcës Ndërkombëtare të Stabilizimit (i nxjerrë nën Autoritetin e Bordit të Paqes) dhe Rregullat e Angazhimit (RREA) për Komandën e Unifikuar të Forcës Ndërkombëtare të Stabilizimit;
 - 2.10. Kufizimet kombëtare në mision, por të cilat nuk do ta tejkalojnë autoritetin e Rregullave të Angazhimit të Forcës Ndërkombëtare të Stabilizimit.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin ta procedojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
 4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/07
Datë: 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 33 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Vlerësimit të Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit të Komunave për vitin 2025.
2. Obligohen Ministria e Financave dhe ministritë e linjës për zbatimin e rekomandimeve nga ky Raport.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/07
Datë: 30.03.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neneve 11, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Nacionale N25, Segmenti QMI-Lipjan, Zona Kadastrale: Suhadoll, Livagjë, Komuna e Graçanicës dhe zonat kadastrale: Konjuh dhe Lipjan, Komuna e Lipjanit, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit të punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij Vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit ua dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bën shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme, ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në raportet e vlerësimit konform legjislacionit në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratin e shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastrale në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Kadastër e Komunës përkatëse është e obliguar t'i kryejë veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/07
Datë: 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 132 të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 12/68, i datës 23.03.2022, për emërimin e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit.
2. Ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, z. Berat Ahmeti, Inspektorati i Tregut (MINTI), zëvendësohet me z. Afrim Fana, Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut; nënparagrafi 2.3., z. Jehon Kadrija, Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit (MINTI), zëvendësohet me z. Nijazi Shala; nënparagrafi 2.4., z. Ibrahim Tërshnjaku (AUVK) zëvendësohet me z. Flamur Kadriu; nënparagrafi 2.5., znj. Venera Agani (BQK) zëvendësohet me znj. Suzan Dërvvari; nënparagrafi 2.7., znj. Rrezarta Ajeti (ARKEP) zëvendësohet me znj. Albina Berisha; nënparagrafi 2.11., znj. Fatbardha Restelica, OJQ "INDEP", zëvendësohet me znj. Doruntina Beka - Latifi, nënparagrafi 2.13., z. Hivzi Dragidella, Oda Ekonomike, zëvendësohet me z. Senad Murati.
3. Ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 2: fshihen plotësisht nënparagrafët 2.9. dhe 2.12., dhe pas nënparagrafit 2.13., shtohen nënparagrafët si në vijim:
 - 2.14. Ibrahim Tërshnjaku, Inspektorati Sanitar - Ministria e Shëndetësisë;
 - 2.15. Granit Sokolaj - OJQ "ALERT";
 - 2.16. Arsim Dreshaj, Komisioni i Pavarur i Mediave;
 - 2.17. Valdete Berisha - Podrimaj, Administrata Tatimore e Kosovës;
 - 2.18. Shqipe Arifaj, Asociacioni i Komunave të Kosovës;
 - 2.19. Egzon Berisha, Autoriteti i Konkurrencës.
4. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 12/68, të datës 23.03.2022.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/07

Datë: 30.03.2026


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 13, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 1,650,000.00€ (një milion e gjashtëqindpesëdhjetë mijë eurosh) në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, me kod 221, nënprogrami Administrata Qendrore me kod 11321, nga kategoria e investimeve kapitale, konkretisht nga projekti "Programi për Zhvillim Rajonal" me kod 18782, në nëntë (9) projekte kapitale në pajtim me Marrëveshjet e Mirëkuptimit për bashkëfinancim të projekteve të nënshkruara nga Ministri i Zhvillimit Rajonal dhe Kryetarët e Komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi riallokohen nga projekti i investimit kapital "Programi për Zhvillim Rajonal" me kod 18782, në këto projekte, me shumatat e cekura si në vijim:
 - 2.1. "Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh – Ferizaj", në Komunën e Ferizajt në shumë prej 200,000.00€, në kodin ekzistues të projektit 19771 (projekti në vazhdim nga viti 2025);
 - 2.2. "Renovimi i Stacionit të Autobusëve – Mitrovicë", në Komunën e Mitrovicës së Jugut në shumë prej 200,000.00€, në kodin ekzistues të projektit 19775 (projekti në vazhdim nga viti 2025);
 - 2.3. "Përmirësimi i infrastrukturës lokale për rritjen e potencialit turistik në Komunën e Junikut", Komuna e Junikut në shumë prej 128,000.00€, në kodin ekzistues të projektit 19782 (projekti në vazhdim nga viti 2025);
 - 2.4. "Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik - Podujevë", në Komunën e Podujevës në shumë prej 200,000.00€, në kodin ekzistues të projektit 19776 (projekti në vazhdim nga viti 2025);
 - 2.5. "Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalanë e Prizrenit - Prizren" në shumë prej 200,000.00€, në kodin ekzistues të projektit 19777 (projekti në vazhdim nga viti 2025);
 - 2.6. "Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në Lagjen e Komuniteteve", në Komunën e Rahovecit, në shumë prej 100,000.00€, në kodin ekzistues të projektit 19784 (projekti në vazhdim nga viti 2025);
 - 2.7. "Ndërtimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - faza III – Shtime" në shumë prej 272,000.00€ euro, në kodin ekzistues të projektit 19778 (projekti në vazhdim nga viti 2025);

- 2.8. "Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike në zonën urbane të qytetit" - në Komunën e Gjilanit, në shumë prej 200,000.00€, në kodin ekzistues të projektit 19781 (projekti në vazhdim nga viti 2025);
- 2.9. "Renovimi i objektit të NPL Stacioni i Autobusëve Gjakovë - Faza II", në Komunën e Gjakovës në shumë prej 150,000.00€, në kod ekzistues të projektit 19772 (projekti në vazhdim nga viti 2025).
3. Fondet e ndara në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, me kod 221, në projektin kapital "Programi për Zhvillim Rajonal" me kod 18782, mund të rialokohen në projekte të reja dhe ekzistuese kapitale pas aprovimit nga Qeveria, në përputhje me marrëveshjen e mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Ministrit të Ministrisë përkatëse dhe Kryetarit të Komunës përkatëse, si dhe nga donatori në rastet kur kërkohet.
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal për zbatimin e këtij Vendimi.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/07
Datë: 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni i Ministrave për Ndërmarrjet Publike, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministria e Ekonomisë, kryesuese;
 - 1.2. Ministri i Financave, anëtar;
 - 1.3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, anëtare;
 - 1.4. Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, anëtar;
 - 1.5. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, anëtare;
 - 1.6. Ministri për Digjitalizim dhe Administratë Publike, anëtar;
 - 1.7. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar.
2. Komisioni sipas pikës 1. të këtij Vendimi, do të paraqesë në Qeverinë e Republikës së Kosovës propozime dhe vërejtje lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 07/14, i datës 28.05.2021.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/07

Datë: 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij Vendimi ta dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas kërkesave të nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/07
Datë: 30.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 9 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën, nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2026, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 05\212, të datës 10.07.2024

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 05\212, i datës 10.07.2024, për emërimin e Bordit Mbikëqyrës të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Trepça" Sh. A., si në vijim:
 - 1.1. Në vend të z. Mentor Berisha, Kryesues i Bordit Mbikëqyrës të Ndërmarrjes Publike Qendrore "Trepça" Sh. A., emërohet z. Shpëtim Dobra, në pozitën e Kryesuesit të Bordit.
2. I emëruari i kryen detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën dhe Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009.
3. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 05\212, të datës 10.07.2024.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë